

LIGJ
Nr.8289, datë 19.2.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8221, DATË 14.5.1997 “PËR RADION DHE
TELEVIZIONIN PUBLIK DHE PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informimit Publik

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8221, datë 14.5.1997 “Për Radion dhe Televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 6, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Këshilli Kombëtar i RT, në përputhje me kërkesat që ka për transmetime radiotelevizive, i kërkon Entit Rregullator të Telekomunikacionit (ERT), të përcaktojë numrin e kanaleve të disponueshme të frekuencave për veprimtari radiotelevizive lokale dhe kombëtare.

ERT detyrohet që brenda 30 ditëve t’i përgjigjet me shkrim kërkesës së Këshillit Kombëtar të RT dhe t’i vërë atij në dispozicion kanalet e lira të frekuencave për veprimtari radiotelevizive.

KKRT jep licencën e transmetimit radioteleviziv, duke u bazuar te kanalet e disponueshme të frekuencave të miratuara nga ERT”.

Neni 2

Neni 6, pika 13, ndryshohet si vijon:

“Jep mendim për perspektivën e veprimtarisë radiotelevizive”.

Neni 3

Kreu III “Planifikimi i frekuencave për radion e televizionin” shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 18 paragrafi i fundit hiqet.

Neni 5

Në nenin 19, paragrafi i parafundit, ndryshohet si vijon:

“Licenca jepet nga Këshilli Kombëtar i RT, i cili organizon për këtë qëllim konkurrim transparent kandidaturash për kanalet e disponuara të frekuencave të transmetimit të ofruara nga ERT. Kanalet e ofruara dhe mbledhja e kandidaturave shpallen publikisht”.

Neni 6

Në kreun VIII, në nenin 68, paragrafi i parë, shprehja: “autoritetet e telekomunikacionit”, zëvendësohet me shprehjen “Enti Rregullator i Telekomunikacionit”.

Në paragrafin e dytë shprehja: “organi shtetëror që jep licenca për telekomunikacionet”, zëvendësohet me shprehjen: “ERT”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2006, datë 3.3.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani